



e Kontur^B

REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I KOSOVËS SKUPŠTINA I KOSOVËS ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përcaktimë Kuvendit (Prop. and Dec. Office)
Mr. Prot. No: 05/2479/10-1230
Date: 15.09.2016
Prishtinë - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z.Imet Rrahmani – Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	15. Shtator 2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Time Kadrijaj – Deputete, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		


Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: I nderuar Minister, ditëve të fundit është folur shumë për pagat e specialistëve. Gjë që po vazhdojnë të mos marrin pagat që iu takojnë specialistet e mjekësisë

Pyetja: A do të rregullohet kjo çështje që të mos ketë të tilla probleme edhe me tutje për specialistët?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	Z. Blerand Stavileci Ministër i Zhvillimit Ekonomik	DATE DATUM DATE	20.09.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Mytaher Haskuka Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		


Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), në valën e privatizimeve ka shitur shumicën e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, por në shumë raste pagesa e punëtorëve e cila njihet si 20% nuk janë realizuar në afatet e parapara e në do raste sia jo e punëtorëve të Gypave të Ferizajit nuk janë realizuar fare. AKP-ja poashtu nuk ka paguar pagat e punëtorëve të cilët ndërmarrjet ju kanë mbetur borxh dhe te cilat janë obligim i AKP-së. Ndër rastet e fundit janë edhe punëtorët e ndërmarrjes "Liria" në Prizren ku më shumë se 100 punëtorë nuk janë paguar 10 pagat e fundit të cilëve AKPja ju ka mbetur borxh për më shumë se 6 muaj nën pretekstin e problemeve me llogaritë bankare. Po ashtu për pagesat e pagave që janë bërë më herët AKP-ja nuk ka deponuar kontributet pensionale, mbasi këto kanë qenë paga për çdo pagesë AKP-ja është dashur që te paguaj në Trustin pensional të Kosovës ashtu si kërkon ligji.

Pyetja:

Çka ka bërë Ministria e Zhvillimit Ekonomik në aspektin e mbikëqyrjes së AKP-së dhe implementimin e të drejtave të punëtorëve sipas ligjeve në fuqi? A ka ndonjë iniciativë të Qeverisë për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve karshi AKP-së dhe për të parandaluar shkeljet e mëtutjeshme të drejtave të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Per ministrin Blerand Staviceli	DATE DATUM DATE	15 shtator 2016
NGA / OD / FROM	Margarita Kadriu Ukelli, deputete		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e rradhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja 1:

. Në një artikull në fund të muajit gusht në gazetën e njohur gjermane, "Frankfurter Allgemeine Zeitung" lexuam se "Axos Capital" ka paditur shtetin e Kosovës para gjyqtarëve të Arbitrazhit në Uashington.

"Axos Capital" kërkon nga Kosova hiç më pak se 390 milionë euro! Rrezikojmë të humbim afro 400 milionë euro për një proces të përcjellë me dyshime, akuza, e plot prapaskena. Një gjë e tillë për Republikën e brishtë do të ishte një goditje dhe tronditje e tmerrshme financiare.

Pyetja 1:

Ju si ministër, a e keni analizuar se kush në Ministrinë që ju e udhëhoqi ka qenë përgjegjës dhe duhet të jap përgjegjësi për rrezikun e humbjes edhe të gati 400 milionë eurove të tatimpaguesve? Çka tash, nëse Kosova e humb kontestin si në rastin e tenderit të pasaportave dhe detyrohet të paguajë edhe 390 milionë euro, një shumë sa një e katërta e buxhetit? Kush është personi përgjegjës juridikisht për këtë? Ku qëndron baza e padisë së AXOS-it dhe kë e keni angazhuar për mbrojtje si dhe sa para e keni kontraktuar?



e Isertur



105/2494/10-1244

20.09.2016

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

PËR / ZA / TO	Znj. Dhurata Hoxha Ministreshë e Drejtësisë	DATE DATUM DATE	20.09.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu <i>Haxhiu</i> Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Më datë 13 korrik të këtij viti keni marrë përsipër udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Ndër të tjerë, në një konferencë para gazetarëve keni deklaruar se do të angazhoheni, "në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar".

PYETJA PARLAMENTARE: Çfarë saktësisht do të bëni?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

e Isertur³

05/2495/10-1245

20.09.2016

PËR / ZA / TO	Z. Memli Krasniqi Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	DATE DATUM DATE	20.09.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Salih Salihu <i>[Signature]</i> Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA:

Zoti ministër që nga pranvera në Kosovë u paraqit sëmundja gungore e gjedheve që në shumicën e rasteve shkaktonte ngordhjen e tyre duke u shkaktuar farmerëve dëme të konsiderueshme ekonomike. Agjensioni i Veterinës dhe Ushqimit që është nën kompetencën e kryemistrit nuk kanë reaguar me kohë as në shërimin e lopëve të sëmura e as në vaksinimin e tyre për të parandaluar përhapjen e mëtutjeshme të virusit që shkakton këtë sëmundje.

Pyetja Parlamentare: Z, ministër a keni planifikuar t'i kimpenzoni farmerët për gjedhet e ngordhura, nëse po sa do të paguani për një gjedhe dhe kur do të bëhet kimpenzimi?